

gjendej në shtëpi. Familjet e tyre, së bashku me banorë të tjerë, i braktisën shtëpitë dhe u strehuan në pyll. Askush nuk dinte çfarë kishte ndodhur me ta. Në mbrëmje, kur krismat pushuan, banorët u kthyen në fshat. Hamit dhe Sheremet Kelmendi e kanë gjetur trupin e pajetë të Mahmutit në rrugë, pranë shtëpisë së tij. E kishte një plagë të madhe në kokë. Në livadh ku Nazifi e ruante bagëtinë, te vendi i quajtur *Dubravë/Dubrava*, kushërinjtë e Nazifit e kanë gjetur trupin e tij. E kishin qëlluar me dy plumba në gjoks. Babai i Rexhepit e ka kërkuar të birin gjithandej fshatit, por nuk e gjeti. Kur ra terri i natës, ai e ndërpreu kërkimin dhe e vazhdoi të nesërmen [9.05.1998]. Nazifi dhe Mahmuti u varrosën më 9.05.1998 në varrezat e fshatit. Pas varrosjes, familjarët e Rexhepit e kanë gjetur trupin e tij në livadhin e vet. E kishin qëlluar në gjoks dhe në këmbë. E kanë varrosur një ditë më vonë në varrezat e fshatit Balincë/Balince. Pas lufte, më 15.04.2000, mbetjet mortore të Nazifit, Mahmutit dhe Rexhepit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Balincë/Balince, ku prehen edhe sot.

Burimet: deklarata I.K, FDH-16008; deklarata S.G, FDH-16573; deklarata S.K, FDH-16574; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 126-127, FDH-23816.

Ahmet (Hysen) Thaçi

(16.01.1931, shqiptar nga Llazica/Lozica, komuna e Malishevës/Mališevo, pensionist, katër fëmijë)

Ahmeti ishte në pension, por punonte si shofer. Në mëngjesin e datës **8.05.1998**, u nis për në fshatin fqinj të Kijevës/Kijevo. Ishte kjo hera e fundit që bashkëshortja Fatime e shihte të gjallë. Dy ditë më vonë, trupin e Ahmetit e kanë gjetur te ura e fshatit [Llazicë/Lozica]. E kishin vrarë me armë zjarri. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Ahmetin në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata T.T, FDH-16584; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.6.5, FDH-30909; USCG KGDH, *Regjistri...*, 56, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 910; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Teroristi muçili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Naim (Deli) Krasniqi

(16.05.1953, rom nga Caralluka/Crni Lug, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor në komunë, i pamartuar)

Naimi ka qenë shef i Zyrës së Ofiqarit në **Carallukë/Crni Lug**. U emërua në këtë post nga administrata serbe. Në datën **18.05.1998**, rreth orës 10:00, një grup i pjesëtarëve të UÇK-së e kanë marrë Naimin nga zyra dhe kanë shtënë mbi të me armë automatike, duke e privuar nga jeta në vend. E kanë varrosur në varrezat e Carallukës/Crni Lug. Varrri i tij mbeti i pa shënuar. Familja e tij është shpërngulur nga Caralluka/Crni Lug menjëherë pas varrimit.

Burimet: deklarata A.LI, FDH-34639; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 225; SMIP, *Teroristički...*, III, 47, 923; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D298.2.3, FDH-30899; *Teroristi muçili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816.

Radovan (Petar) Staletić

(3.01.1925, serb nga Mleqani/Mlečane, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, pesë fëmijë)

Branislav (Radovan) Staletić

(25.11.1960, serb nga Mleqani/Mlečane, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor)

Radovani merrej me bujqësi, ndërkaq i biri Branislavi punonte në fabrikën e *Ferronikelit* në Glllogoc/Glogovac. UÇK-ja e ka kryer një sulm ndaj **Mleqanit/Mlečane** më 24.05.1998. Kjo i detyroi të gjithë serbët [12 familje] që të zhvendoseshin në fshatin fqinj të Kijevës/Kijevo, ku gjendej policia serbe. Radovani ka mbetur vetëm në fshat. Tri ditë më vonë, më **27.05.1998**, Branislavi u nis për në Mleqan/Mlečane, për ta vizituar të atin. Nga ajo ditë, u zhdukën tërësisht të gjitha gjurmët e tij. Mbetjet mortore të Radovanit dhe Branislavit u zbuluan në një varrezë masive në muajin maj të vitit 2005, në afërsi të spitalit të Malishevës/Mališevo. Pas identifikimit të tyre, që u krye në Institutin për Mjekësinë